



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 4.3.2021, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Antoneta Dhima, Elona Hoxha, Elena Xhina, Artemis Malo, Xhemal Qefalia, Luan Duzha, Sadi Vorpsi, Lefter Maliqi, Edmond Rrushi, Ylli Shehu, Arben Elezi, Nimet Musaj, Edmond Stojku dhe Spartak Braho.

Mungojnë:

Alban Zeneli, Paulin Sterkaj, Anduel Xhindi, Luan Harusha dhe Myslim Murrizi.

Të ftuar:

Petro Koçi - Zëvendësministër i Mbrojtjes

Elton Hodaj - Jurist i Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj - Mirëmëngjesi, kolegë!

Çelimi mbledhjen e Komisionit parlamentar për Sigurinë Kombëtare.

Sot në rendin e ditës do të kemi vetëm shqyrtimin në parim të projektligjit "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë".

Në fakt, ky është një projekt i cili do të diskutohet në tri komisione parlamentare dhe vetëm pasi të jetë mbyllur diskutimi në tërësi në Komisionin e Shëndetësisë dhe në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese do të mundemi edhe ne të bëjmë diskutimin nën për nën dhe atë në tërësi.

Për prezantimin e përmbajtjes së këtij projektligji, sot kemi të ftuar zotin Petro Koçi, zëvendësministër i Mbrojtjes.

Faleminderit, zoti Koçi!

Kemi të ftuar edhe zotin Elton Hodaj, jurist i Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksperteve.

Relatore e Komisionit të Sigurisë për këtë projektligj do të jetë zonja Dhima.

Po ia jap fjalën zotit Koçi, që ta na bëjë një prezantim të këtij projektligji. Më pas fjalën e ka relatorja.

Fjala është për ju, zoti Koçi.

Petro Koçi - Faleminderit, zonja kryetare!

Përhëndetje të gjithë anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit të Sigurisë Kombëtare!

Ligji "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë" është shumë teknik dhe është dashur shumë punë për ta hartuar.

Në këtë rast më lejoni ta filloj duke falënderuar të gjithë grupin e punës, i cili, natyrisht, ka për protagonist përfaqësuesin e AKSHE-së, që është edhe sot në lidhjen e drejtpërdrejtë, pra ekspertin jurist Elton Hodaj, por edhe përfaqësues të tjerë nga Ministria e Brendshme, përkatësisht nga Policia e Shtetit, si dhe nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, sepse janë aspekte të cilat i mbulojnë drejtpërdrejt këto ministri! Natyrisht, Ministria e Mbrojtjes është udhëheqëse e hartimit të këtij projektligji, sepse AKSHE-ja është në varësinë e saj, por, siç e thashë, produkti është një kontribut i të gjithë grupit të punës.

Gjithashtu, më lejoni të them që nevoja për rishikimin e ligjit aktual në fuqi, i cili, në fakt, e ka edhe titullin ndryshe (është një ligj që mbikëqyr hedhjen në treg dhe trajtimin e lëndëve plasëse), ka ardhur përgjithësisht për shkak të direktivës europiane të 12 qershorit të vitit 2013, dhe në kuadrin e planit kombëtar të integritimit europian na duhej patjetër ta

përafronim të paktën pjesërisht këtë direktivë me legjislacionin shqiptar. Kjo e bëri të domosdoshme që ligji më pas të ishte dhe pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që buronin nga Ministria e Mbrojtjes.

Qëllimi i ligjit është garantimi i një sistemi efikas të kontrollit, të mbikëqyrjes së tregut, vlerësimit të përputhshmërisë së artikujve piroteknikë; përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të të gjithë operatorëve ekonomikë që veprojnë në tregun tonë kombëtar, si dhe përcaktimi i përgjegjësive në të gjithë zinxhirin e furnizimit me këto lloj artiikujsh.

Duhet kuptuar që artikujt piroteknikë, natyrisht, përdoren për qëllime civile, por kanë edhe rreziqe gjatë procesit të përdorimit të tyre. Prandaj, siç ju thashë edhe në fillim, ligji është shumë teknik dhe është dashur një punë shumë e madhe për të parë në detaje jo vetëm direktivën e 2013-s të Bashkimit Europian, por edhe për të përfituar nga përvoja e deritanishme e agjencive tona, që janë marrë me trajtimin e lëndëve plasëse, por edhe me artikujt piroteknikë njëkohësisht.

Gjithashtu, dua të kujtoj që për lëndët plasëse, po themi, ne kemi një projekt tjetër, i cili do të vijë së shpejti edhe në komisionin tuaj.

Projektligji ka disa të reja, që lidhen jo vetëm me ndarjen e objektit të ligjit, pra nga lëndët plasëse, por edhe me terminologjinë e re, procesin e licencimit, rregullat teknike, kushtet e sigurisë, procedurat për organet e miratuara, që janë në përmbajtje të projektligjit dhe vlerësimin e përputhshmërisë, sidomos më aspektin teknik dhe jo thjesht ligjor. Është shumë i rëndësishëm përcaktimi i masave të sigurisë që vetë operatorët ekonomikë duhet të marrin gjatë gjithë procesit të hedhjes në treg, momentin e magazinimit, furnizimit etj, si dhe përcaktimin e organeve ligjzbatuese, të cilat merren me të gjitha këto aspekte të rëndësishme, që përcakton ligji. Është i rëndësishëm edhe përcaktimi i kategorive të lëndëve piroteknike, por edhe kategorizimi i moshave që lejohen të përdorin këto lloj kategorish të lëndëve piroteknike gjatë momenteve të caktuara jo vetëm në procesin e tregtimit të tyre, por sidomos gjatë përdorimit. Ju e dini që sidomos fëmijët janë shumë të dhënë pas përdorimit të lëndëve piroteknike, sidomos gjatë festave, siç është fundviti, apo fillimviti.

Kështu që do të thosha që kemi bërë më të mirën që të kemi një përputhje të pjesshme me direktivën, është e pjesshme se një pjesë e direktivës lidhet me vendet që janë *gia* anëtare të BE-së, ne nuk jemi akoma anëtarë të BE-së, por lidhet edhe me natyrën e secilit vend që zbaton këtë direktivë, sepse varet nga natyra e organeve kompetente që duhet merren me trajtimin e kësaj çështjeje. Ligji është në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe rendin juridik të brendshëm, por edhe me atë ndërkombëtar, por ajo që është kryesorja është se përafron direktivën dhe është pjesë e paketës së integritimit tonë europian. Nga ana tjetër dua të them që

kemi bërë shumë kujdes me procesin e licencimeve dhe të autorizimeve, e kemi zgjatur aq sa e kemi quajtur të logjikshme dhënien e afatit të tyre, pra për të mos e bërë kaq frekvente në mënyrë që të mos krijojmë hapësira abuzimi me këtë pjesë, sepse duke qenë një proces delikat dhe i rrezikshëm kuptohet që organet kompetente duhet të mbikëqyrin me shumë kujdes procesin, por ne jemi përpjekur që të shohim edhe interesat e operatorëve ekonomikë, të cilët natyrisht kërkojnë që hapësirat të jenë sa më liberale. Ne kemi ditur të krijojmë një harmoni të plotë mes kushteve të garantuara të sigurisë dhe të mbikëqyrjes së rreptë të tregut, por edhe të zhdukjes së hapësirave për abuzime nga autoritetet kompetente, që japin licencat, apo autorizimin.

Faleminderit!

Besoj se sot është vetëm shqyrtimi në parim, ligji është i lodhshëm nga pikëpamja teknike dhe besoj se kur të vini te pjesa nen për nen do të duhej që eksperti Hodaj të ishte shumë aktiv, që të sqaronte momente që anëtarët e komisionit tuaj, por edhe të dy komisioneve të tjera do të kenë në procesin e shqyrtimit.

Faleminderit, zonja kryetare!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Koçi për prezantimin e përmbledhur nga ana juaj!

Kuptohet që hyrja në fuqi e projektligjit “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë” do të shfuqizojë veprimin e ligjit aktual “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, një ligj që daton që prej vitit 2003 dhe vetëm koha kur është bërë ky ligj na tregon qartësisht se prej vitit 2003 deri sot në 2021-n se qarkullimi dhe llojshmëria e artikujve piroteknikë kanë pësuar ndryshime. Të gjitha këto arsye bëjnë të nevojshme që ne sot të kemi një projekt të ri. Unë shpresoj që ky të jetë realisht një projekt shumë i mirë.

Do t’ia jap fjalën zonjës Dhima, duke iu lutur që të mos biem në përsëritje, por mundësisht të kemi vetëm disa momente të tjera, të reja, që janë edhe pjesë e përgjegjësive të këtij komisioni, që lidhen me ligjin në fjalë.

Pastaj, për pyetjet, zoti Koçi e tha në fjalën e tij, kemi këtu ekspertin Elton Hodaj, ndaj besoj se disa pyetje parimore do të mund t’i ndajmë sot me të.

Faleminderit!

Fjala është për ju, zonja Dhima!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Falënderoj zotin zëvendësministër për prezantimin e projektligjit.

Në fakt, në fjalën e tij, zoti zëvendësministër theksoi rëndësinë dhe qëllimin që ka hartimi dhe miratimi i këtij projektligji.

Me miratimin e projektligjit, do të bëhet i mundur përafrimi i legjislacionit të Bashkimit European, konkretisht me direktivën, gjë e cila po ashtu u theksua nga ana e tij.

Gjithashtu, projektligji është parashikuar në kuadrin e përgjithshëm analitik të projektakteve për Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2020, si dhe në planin kombëtar të integritit european 2019 – 2021.

Edhe në fjalën tuaj, ju e thatë se ky ligj që faktikisht është në fuqi ka gati 15 vjet që është në fuqi, ndaj patjetër që ka lindur nevoja për ndryshime thelbësore, pasi ligji në fjalë mbulon dy fusha kryesore: mbulon lëndët plasëse për përdorim civil, si dhe artikujt piroteknik e fishekzjarrët për përdorim civil.

Ndryshimet janë të domosdoshme, për shkak edhe të gjithë kësaj periudhe të gjatë që ky ligj është në fuqi. Në vitin 2013 Bashkimi European ka miratuar direktivën 2013/29 të BE-së, të Parlamentit European, si dhe të këshillit, që është miratuar më datë 12 qershor 2013 “Për harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me bërjen të disponueshme në treg të artikujve piroteknikë”.

Ky projektligj është në përputhje të pjesshme me këtë direktivë, pasi ai transponon pjesën më të madhe të saj, duke mos përafruar vetëm ato nene që janë relevante për vendet anëtare të Bashkimit European.

Faktikisht, ligji që është në fuqi bashkërendon punën e disa institucioneve të përfshira në mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë, por paraqet mangësi të theksuara në përkufizime, në përcaktimin e llojeve të aktiviteteve, në parashikimin e dispozitave për kontrollin e artikujve piroteknikë, si dhe për sa u përket sanksioneve.

Duke qenë se trajtimi, mbikëqyrja e lëndëve paraqet praktika të ndryshme me atë të artikujve piroteknikë, duke qenë se edhe legjislacioni i Bashkimit European e trajton në mënyrë të veçantë, fusha e lëndëve plasëse është ndarë nga objekti i këtij projektligji dhe do të trajtohet me një ligj të veçantë.

Ky projektligj të cilin ne sot po e diskutojmë në parim, ndërsa ditëve në vazhdim do ta diskutojmë nen për nen, e ndryshon thelbësisht ligjin e mëparshëm, duke futur koncepte të reja, si dhe duke e ndryshuar dhe përputhur atë me direktivën, si në terminologji, ashtu edhe në licencime, në rregullat teknike, në kushtet e sigurisë, në procedurat për organet e miratuara, të cilat do të bëjnë vlerësimin e përputhshmërisë.

Gjithashtu, në këtë projektligj janë përcaktuar edhe masat e sigurisë, që duhet të ndërmerren nga operatorët ekonomikë gjatë aktiviteteve me artikujt piroteknikë, si dhe trajtimet dhe kualifikimet e nevojshme të personave specialistë, të cilët do të merren me trajtimin e këtyre artikujve.

Një element tjetër shumë i rëndësishëm, i cili sjell risi në hartimin e këtij projektligji, është edhe kategorizimi i artikujve piroteknikë, si dhe përcaktimi i kufijve të moshës në lidhje me përdorimin e tyre.

Në këtë projektligj përcaktohet se operatorët ekonomikë duhet të jenë përgjegjës në lidhje me përputhshmërinë e artikujve piroteknikë me dispozitat e projektligjit, sa u përket roleve të tyre përkatëse në zinxhirin e furnizimit, në mënyrë që të sigurohet një nivel i lartë i mbrojtjes së interesave publike, si shëndeti, siguria e personave, siguria publike, për të garantuar kështu konkurrencën e ndershme. Ky projektligj duhet të zbatohet për të gjitha format e furnizimit. Të gjithë operatorët ekonomikë, që ndërhyjnë në zinxhirin e furnizimit dhe shpërndarjes, duhet të marrin masat e duhura për të siguruar që ata bëjnë të disponueshëm në treg artikuj piroteknikë, që janë në përputhje me këtë projektligj. Gjithashtu, është e nevojshme të sigurohet një shpërndarje e qartë dhe proporcionale e detyrimeve që korrespondojnë me rolin e secilit operator ekonomikë në zinxhirin e furnizimit dhe shpërndarjes.

Siç e tha edhe zoti Koçi, ky projektligj është hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër të Kryeministrit dhe me përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ky projektligj nuk ka efekte apo kosto shtesë për buxhetin e shtetit. Projektligji është i përbërë nga 5 krerë, 36 nene dhe 3 shtojca, të cilat ne do t'i diskutojmë dhe do t'i vlerësojmë në momentin kur të kalojmë në diskutimin e këtij projektligji nen për nen.

Duke u nisur nga argumentet e mësipërme, si dhe nga argumentet që ju, zonja kryetare, dhe zëvendësministri, thatë në fjalën tuaj, unë do t'i ftoj të gjithë kolegët që ta miratojmë këtë projektligj!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Dhima!

Diskutimi është i hapur për kolegët, si dhe për pyetje.

Po filloj unë me një pyetje për zotin Hodaj.

Do të doja të dija në mënyrë të përmbledhur se cili është roli i autoriteti ku ju bëni pjesë në raport me projektligjin e ri “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”.

Elton Hodaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Roli i Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve në fushën e artikujve piroteknikë për përdorim civil konsiston në licencimin e aktivitetit të importit, të eksportit, prodhimit dhe tranzitimit të këtyre artikujve.

Ky aktivitet që ne licencojmë kryhet në bashkëpunim me institucionet e tjera, pasi të gjitha institucionet në faza të ndryshme kontrollojnë lëvizjen e artikujve piroteknikë deri në hedhjen në treg dhe ne kemi pjesën e kontrollit, në qoftë se mund të quhet kështu, të jashtëm dhe të prodhimit.

Ndërkohë, Policia e Shtetit ka kontrollin brenda vendit, në magazinim dhe në shitje.

Ermonela Felaj – A mund të kemi një të dhënë, nëse ka operatorë në Shqipëri që janë të licencuar për prodhimin e artikujve piroteknikë?

Cilët janë këto artikuj konkretisht?

Elton Hodaj – Ne kemi një operator, i cili është prodhues i artikujve piroteknikë, kapsolla. Aktualisht, siç është përcaktuar edhe te raporti i vlerësimit, situata me artikujt piroteknikë nuk është në nivelet që ka qenë më përpara, pasi në bazë të një urdhri të tre ministrave, artikujt piroteknikë tashmë janë bllokuar për import dhe për prodhim. Me këtë ligj të ri ne do të donim të bënim zhblokimin e tregut të artikujve piroteknikë, por me kushtet e duhura të sigurisë, pasi ka pasur problematika të mëparshme, të cilat kanë qenë edhe mediatike, kur artikujt piroteknikë janë keqpërdorur.

Mungesa e sanksioneve të ligji i mëparshëm, çka u përmend edhe nga zëvendësministri dhe zonja Dhima, ka qenë një gëp për ne për të ndëshkuar ose për të parandaluar ngjarjet e të cilat janë ardhur më vonë.

Në këtë situatë që jemi tani kemi vetëm një prodhues, i cili aktualisht nuk prodhon, pasi janë hequr licencat. Kemi tre importues të artikujve piroteknikë dhe një eksportues, që është prapë prodhuesi.

Ermonela Felaj – Kam edhe një pyetje tjetër: a mund të na e shpjegoni se cila është diferenca midis lëndëve plasëse dhe artikujve piroteknikë? U tha edhe nga relatorja se nuk do të jetë i njëjti rregullim ligjor për të dyja dhe ka një ndryshim mes artikujve piroteknikë dhe lëndëve plasëse.

Elton Hodaj – Lëndët plasëse për përdorim civil janë lëndët që përdoren për veprimtari civile, si: në miniera, në gurore, në hapjen e rrugëve dhe nuk përdoren nga publiku i gjerë, por përdoren nga persona dhe kompani të specializuara për këto aktivitete.

Artikujt piroteknikë për përdorim civil janë fishekzjarrët, të cilët shiten, deri diku, lirshëm. Janë edhe disa artikujt të tjerë piroteknikë që quhen artikuj piroteknikë teatralë që përdoren në televizione ose në skena për të krijuar efektet televizive që të gjithë i shikojmë. Janë edhe disa lloje të tjera të artikujve piroteknike, të cilat janë në *airbag*-at e makinave ose në rripat e sigurimit. Ato kanë një ngarkesë të lehtë eksplozive, e cila quhet piroteknike, por në tërësinë e tyre, pavarësisht fuqisë së betonimit dhe karakteristikave teknike, diferenca më e

madhe është fakti se lëndët plasëse janë për përdorim industrial, për kompani dhe individë të specializuar për ato qëllime. Ndërkohë që artikujt piroteknikë shkojnë edhe për publikun e gjerë.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Pse lindi nevoja të kemi rregullime të ndryshme me legjislacion të ndryshëm për secilën nga këto, apo është fusha e gjerë përdorimit të secilës?

Elton Hodaj - E para, teknikisht janë të ndryshme, qoftë lëndët plasëse, qoftë artikujt piroteknikë. Në momentin që teknikisht janë të ndryshme, edhe përkufizimet e tyre ndryshojnë, edhe mënyra e përdorimit, trajtimit të tyre nga individët ose nga personat e specializuar ndryshon. Kushtet e sigurisë për përdorimin, mbajtjen, magazinimin, transportin e lëndës plasëse ndryshojnë nga ato për artikujt piroteknikë.

Operatorët ekonomikë, që veprojnë në këto fusha, janë komplet të ndryshëm dhe nuk kanë lidhje me njëri-tjetrin, pra, nëse duke vazhduar më tej, do të kishim të njëjta masa parandaluese në kuptimin e kushteve të sigurisë apo në kuptimin e sanksioneve do t'ua vendosnim njëlloj si operatorëve ekonomikë të lëndëve plasëse, të cilët kanë një rrezikshmëri shumë herë më të lartë, edhe operatorëve ekonomikë të artikujve piroteknikë. Nuk mund të gjenim një proporcionalitet në këtë pikë, nëse do të kishim vetëm një ligj.

Ky ligj është me 36 nene, me 2 shtojca, do të shkonte ndoshta me 100 nene, me 5-6 shtojca dhe do të ishte goxha më i vështirë për t'u zbatuar, duke pasur parasysh që jemi mbi 4-5 institucione që kemi kompetenca monitoruese, verifikuese në këtë fushë.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Hodaj!

Në fakt, edhe ne patëm rast të bënim një krahasim të thjeshtë mes përmbajtjes së ligjit aktual “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë” dhe projektligjit që po diskutohet. Ligji aktual ka vetëm 14 nene, me gjithë hyrjen në fuqi, ndërkohë që projektligji ynë ka 35 nene, gjë që tregon se fusha ka pësuar ndryshime të ndjeshme dhe këto duhet të reflektohen në legjislacion.

Elton Hodaj – Në hartimin e tij në fillim ka pasur akoma më shumë nene.

Ermonela Felaj – Zonja Dhima, ka një pyetje.

Ndjesë, zoti Koçi!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Kam një pyetje për zotin Hodaj. Një nen shumë i rëndësishëm i këtij projektligji janë edhe kundërvajtjet administrative për shkeljet e dispozitave të këtij ligji nga operatorët ekonomikë, sipas rolit dhe përgjegjësisë së tyre, të cilat variojnë nga 200-500 mijë dhe nga

100-200 mijë. Unë dua të di nga ju: a ka një referencë, ose kujt i jeni referuar për vendosjen e këtyre masave administrative, sepse këto nuk janë vepra penale?

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Elton Hodaj - Faleminderit për pyetjen!

Në hartimin e kundërvajtjeve administrative, siç e theksova, te ligji i parë nuk kemi pasur fare dhe kemi pasur një problematikë të madhe në sanksionimin e ndonjë kundërvajtjeje administrative tek operatorët ekonomikë, por kemi pasur vetëm mundësinë vetëm për pezullim dhe heqje licence, ndërkohë që nuk kishim mundësi të tjera për të vendosur gjoba, që ata të vetëkorrigjoheshin gjatë procesit të punës.

Çfarë kemi bërë dhe si i kemi ndarë?! Ne kemi bërë një ndarje proporcionale, ku kemi parë edhe modele të këtij legjislacioni nga vendet e rajonit, ku kryesisht kemi parë modelin e Kroacisë, e cila e kishte të përcaktuar pjesën e sanksioneve në mënyrën më të detajuar nga të gjitha modelet që kishim parë nga vendet e tjera të rajonit, dhe i kemi ndarë nga kundërvajtjet administrative, të cilat mendojmë se janë më të rëndat, siç mund të jetë testimi i artikujve piroteknikë pa lejen e duhur, të cilat mund të shkaktojnë një incident, një rrezikshmëri më të lartë sesa mund të jetë një raportim pranë një institucioni, që ka një rrezikshmëri më të ulët, por që edhe ajo përbën një kundërvajtje administrative. Pra, jemi munduar që të japim një proporcionalitet nga shkalla rritëse, duke e nisur nga gjobat 200-500 mijë lekë, deri në një shkallë më të ulët, të marrëdhëniet që subjekti do të ketë me autoritetet: të raportimet, të dokumentacioni, që duhet të mbajë në objektin e vet ose në ambientet e veta. Ndërkohë, veprimet, të cilat sjellin një rrezikshmëri ndaj njerëzve, mjedisit dhe pronës shkojnë në kundërvajtje më të mëdha administrative.

Ermonela Felaj- Faleminderit, zoti Hodaj!

Zoti Koci, fjala për ju.

Petro Koçi - Faleminderit, zonja kryetare!

E gjeta me shumë interes pyetjen tuaj lidhur me dallimin midis karakteristikave të lëndëve apo mallrave piroteknike me lëndët plasëse. Ky është një dallim i madh dhe besoj se ka lidhje me natyrën e përdorimit në drejtim të shpërdorimit të tyre. Domethënë, nëse lëndët piroteknike, duke u shpërdoruar, mund të shkaktojnë pasiguri dhe alarmim të qytetarët, lëndët plasëse mund të përdoren edhe për qëllime kriminale, prandaj edhe natyra e tyre është shumë e ndryshme, duheshin trajtuar që në fillim me ligje të ndryshme. Kështu që, ne po e bëjmë këtë gjë tani.... Imagjinoni, kushtet e sigurisë që duhen kontrolluar lëndët plasëse nuk krahasohen

me kushtet e sigurisë së përdorimit të lëndëve piroteknike, pra janë shumë të ndryshme. Prandaj, mendoj se pyetja juaj ishte shumë e rëndësishme.

Faleminderit!

Ermonela Felaj- Faleminderit!

Doja të dija: a është gati projektligjin për lëndët plasëse? Derisa ky projektligj të jetë gati për të hyrë në fuqi, si do të bëhet rregullimi i tregut, ose i lëvizjes së qarkullimit të lëndëve plasëse në Shqipëri për nevoja civile, sepse përdorimi, në kundërshtim me ligjin, është i dënueshëm?

Po, zoti Hodaj.

Elton Hodaj - Sapo u informova nga kolegët e Ministrisë së Mbrojtjes, projektligji për lëndët plasëse ka kaluar në Këshill të Ministrave dhe do të përcillet së shpejti në parlament. Ne kemi punuar për të dy projektligjet në të njëjtën kohë, por, në varësi të problematikave që kemi hasur gjatë procesit, mendimeve dhe komenteve, piroteknika kaloi pak më parë, por do të vijë praktikisht në të njëjtën kohë në parlament.

Ermonela Felaj – Kjo është një gjë shumë e mirë, sepse nuk krijon boshllëqe në rregullimin ligjor dhe na ndihmon shumë diskutimi në një kohë të afërt të secilit prej projekteve.

A ka pyetje të tjera nga kolegët?

Zoti Duzha, meqenëse, ju e njihni pak a shumë fushën, do të doja një qëndrim tuajin?

Luan Duzha – Faleminderit, zonja kryetare!

Dua të di se cili është operatori për prodhimin, sepse vërtet artikujt piroteknikë nuk janë të rrezikshëm, kur janë prodhuar, por rrezikshmëria e tyre qëndron gjatë prodhimit. Specialisti duhet ta dijë, sepse, në dijeninë time, artikujt piroteknikë lëndë bazë kanë barutin e zi, i cili është jashtëzakonisht i rrezikshëm, në krahasim me barutet e tjera, pasi ai edhe vetëndizet gjatë punimit për një ngarkesë elektrike që mund të ketë trupi. Pra, këtë kam, pra që prodhimi i artikujve piroteknikë mbart në vetvete një rrezikshmëri të lartë, prandaj do kushte specifike, në të cilat ai mund të prodhohet.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Sigurisht që mbikëqyrja për të gjithë ata që licencohen, për të gjitha ata që do ta prodhojnë për sa i takon zbatimit të rregullave të sigurisë duhet të jetë maksimale.

Zoti Hodaj, a keni diçka në vijim të ndërhyrjes së kolegut?

Elton Hodaj – Po t'i shikojmë nenet e fundit të këtij projektligji, pasi janë disa nene, të cilat përcaktojnë kushtet e sigurisë që duhet të përmbushin operatorët ekonomikë, qoftë prodhuesit, duke vënë detyrime akoma më të forta për sa i përket personelit, i cili do t'i përdorë këto artikuj, sepse teknologjia është diçka tjetër dhe lëndët, të cilat do të përdoren për

prodhimin e artikujve piroteknikë, janë testuar dhe janë certifikuara, sepse vendosen nga një laborator i huaj i Bashkimit Europian, ashtu siç e ka Bashkimit Europian. Ajo, të cilën ne konsideronim me rrezik, ishte pjesa e prodhimit dhe e përdorimit nga personat këtu në Shqipëri. Ne donim disa certifikime dhe disa trajnime të këtij personeli dhe këtë e kemi vendosur te nenet e masave të sigurisë që duhet të marrin operatorët ekonomikë. Nga ana tjetër, te nenet përkatëse për inspektimin kemi vendosur edhe fuqi inspektuese për të gjitha autoritetet e përfshira në këtë proces, duke u dhënë më shumë kompetenca dhe më shumë lirshmëri mbikëqyrjes ndaj këtyre operatorëve ekonomikë prej autoriteteve shtetërore, të cilat më parë nuk ishin shumë të qarta ose, praktikisht, nuk ishin fare të ligji i vjetër.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Hodaj!

Nuk e di a ka pyetje dhe diskutime të tjera nga kolegët në lidhje me projektin? Në qoftë se nuk ka pyetje dhe diskutime, ftoj kolegët prezentë që të aksesohen me figurë që të mund të bënim votimin në parim të projektit. Po ashtu, dua të siguroj zotin Koçi, si zëvendësministër i Mbrojtjes, dhe zotin Elton Hodaj, si përfaqësues i AKSHE-së, që ne do t'i ushtrojmë përgjegjësitë tona deri në fund, duke bërë të mundur që ky projekt, që realisht duket i nevojshëm dhe i qasur ashtu siç duhet, të mund të hyjë në fuqi brenda kësaj legjislature.

Kolegë, ju ftoj për votimin në parim të projektligjit “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”.

Kush është dakord me këtë projekt? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektligji.

Faleminderit, zoti Koçi, zoti Hodaj, zonja Dhima dhe të gjithë kolegët e Komisionit të Sigurisë për angazhimin në ditën e sotme!

Sigurisht, ne jemi të kushtëzuar për diskutimin nën për nen, sepse na duhet të marrim edhe opinionet e komisioneve të tjera, që janë caktuar për të dhënë opinione në lidhje me këtë projektligj.

Kështu që, duke ju uruar një fundjavë sa më të mbarë dhe me lajme sa më të mira për secilin, mirupafshim!

MBYLLET MBLEDHJA